



Emri dhe mbiemri i garuesit: _____
Emri dhe mbiemri i mentorit: _____
Shkolla: _____ Komuna: _____

PËR KOMISIONIN
Gjithësej pikë: _____
Prej pyetjeve: _____ prej detyrave: _____
Kontrolloi: _____

I. TEST ME MË SHUMË PËRGGJIGJE TË DHËNA PREJ TË CILAVE VETËM NJËRA ËSHTË E SAKTË
(Përgjigjuni në atë mënyrë, duke rrethuar **vetëm një** prej opsioneve të dhëna A, B, C, D ose E)

- Diamanti është i ndërtuar nga:
A. Dy lloje të ndryshme të atomeve.
B. Një lloj atomi.
C. Dy lloje të joneve.
D. Molekulave.
E. Tetraedrave.
- Nga cilat lloje të grimcave mund të përbëhen substancat e thjeshta?
A. Vetëm prej joneve.
B. Vetëm prej atomeve.
C. Vetëm prej molekulave.
D. Prej atomeve dhe molekulave.
E. Prej atomeve dhe joneve.
- Gjeje cili prej opsioneve të dhëna nuk e ka vendin këtu!
A. Elektroliza.
B. Djegia.
C. Ndryshkja.
D. Avullimi.
E. Reduktimi.
- Substanca të thjeshta janë:
A. Zhiva.
B. Grafiti.
C. Ksenoni.
D. Fluori.
E. Të gjitha opsionet e dhëna.
- Simboli kimik i arit është:
A. Ag
B. Au
C. Az
D. Go
E. Zl
- Prej formulës $\text{Al}(\text{NO}_3)_3$ mund të konstatohet se:
A. Raporti sasiar i aluminit, azotit dhe oksigjenit në këtë komponim është 1:1:3.
B. Raporti sasiar i aluminit, azotit dhe oksigjenit në këtë komponim është 1:3:3.
C. Raporti sasiar i aluminit, azotit dhe oksigjenit në këtë komponim është 1:3:9.
D. Raporti masor i aluminit, azotit dhe oksigjenit në këtë komponim është 1:3:9.
E. Të sakta janë opsionet C dhe D.
- Në komponimin SO_3 sulfuri është:
A. Një valent.
B. Dy valent.
C. Tri valent.
D. Katër valent.
E. Gjashtë valent.
- Në 1 mol As_2O_5 gjenden:
A. $6,02 \cdot 10^{23}$ molekula oksid arseni (V).
B. $6,02 \cdot 10^{23}$ atome arsen.
C. $6,02 \cdot 10^{23}$ atome oksigjen.
D. Të 3 opsionet (A, B, C) janë të sakta.
E. Të 3 opsionet (A, B, C) nuk janë të sakta.
- Cilët janë koeficientët e duhur që duhet të qëndrojnë përpara formulave kimike që ekuacioni kimik të jetë i barazuar:
$$\text{Pb}(\text{NO}_3)_2 + \text{AlCl}_3 \rightarrow \text{PbCl}_2 + \text{Al}(\text{NO}_3)_3$$

A. 1,1,1,1
B. 2,1,2,1
C. 3,1,3,1
D. 3,2,3,2
E. Asnjëri prej opsioneve të dhëna nuk është i saktë.
- Pjesëmarrja sasiore e sulfurit në trioksidin e sulfurit është:
A. 50 %.
B. 40 %.
C. 25 %.
D. 10 %.
E. Asnjëri prej opsioneve të dhëna nuk është i saktë.
- Rretho pohimin e saktë!
A. Në përbërjen e çdo atomi bëjnë pjesë numër i njëjtë i protoneve dhe elektroneve.
B. Në çdo bërthamë atomike numri i protoneve është i njëjtë me numrin e neutroneve..
C. Numri i neutroneve në bërthamat e atomeve është i njëjtë me numrin e elektroneve në mbështjellësin elektronik.
D. Shuma e numrit të neutroneve dhe protoneve që gjenden në bërthamë është e njëjtë me numrin e elektroneve në mbështjellësin elektronik.
E. Shuma e numrit të neutroneve dhe protoneve në bërthamën atomike quhet numri atomik.

12. Nuklidet $^{79}_{35}\text{Br}$ dhe $^{81}_{35}\text{Br}$ janë:
- Izobare.
 - Izomere.
 - Izotope.
 - Izohore.
 - Izohipse.
13. Atomi i deuteriumit përbëhet prej:
- 1 protoni dhe 1 elektroni.
 - 1 protoni dhe 1 neutroni.
 - 1 neutroni dhe 1 elektroni.
 - 1 protoni, 1 neutroni dhe 1 elektroni.
 - 1 protoni, 2 neutroneve dhe 1 elektroni.
14. Kombinimi në vazhdim i numrave kuantik $n = 5$, $l = 3$, $m_l = 1$ ka të bëjë me:
- Njëren prej $5p$ orbitaleve.
 - Njëren prej $5d$ orbitaleve.
 - Njëren prej $5f$ orbitaleve.
 - Të gjitha orbitalet e nivelit (shtresës) së pestë.
 - Ky kombinim nuk është i mundshëm.
15. Rretho përgjigjen e saktë!
- Ceziumi është elementi më elektronegativ.
 - Energjia e parë e jonizimit të cesiumi është shumë më e vogël se sa tek bromi dhe klori.
 - Në sistemin periodik duke shkuar prej të majtës në të djathtë në një periudë energjia e parë e jonizimit zvogëlohet.
 - Gazrat inerte (fisnike) kanë vlera më të vogla të energjive të jonizimit.
 - Në një grup të caktuar të sistemit periodik duke shkruar prej lartë poshtë elektronegativiteti rritet.
16. Konfiguracioni elektronik i nivelit të fundit: ns^2np^5 është karakteristik për:
- Elementet alkaline
 - Elementet alkalino-tokësore
 - Elementet halkogjene.
 - Elementet halogjene.
 - Gazrat inerte.
17. Te molekula e bromit, lidhja kovalente arrihet:
- Me dhënien e një elektronit nga ana e njërit atom dhe pranimit i tij nga atomi tjetër dhe tërheqjes elektrostatike në mes të joneve të formuara.
 - Formimin e çiftit të përbashkët elektronik, çift ky që në mënyrë të barabartë u takon të dy atomeve.
 - Formimin e dy çifteve të përbashkëta elektronike, çifte këto që në mënyrë të barabartë u takojnë të dy atomeve.
 - Formimin e një çifti të përbashkët elektornik, çift që më shumë i takon njërit atom.
 - Hibridizimin e orbitaleve atomike.
18. Te kloruri i magnezit, magnezi dhe klori janë të lidhura me:
- Lidhje jonike.
 - Lidhje kovalente polare.
 - Lidhje kovalente jopolare.
 - Lidhje metalike.
 - Lidhje jometalike.
19. Lidhja kovalente polare ekziston te:
- CHCl_3 .
 - NH_3 .
 - HBr .
 - Te të tri opsionet e dhëna.
 - Te asnjëra nga opsionet e dhëna.
20. Galeniti (PbS) është shembull i një kristali tek i cili njësitë përbërëse janë:
- Molekulat.
 - Atomt.
 - Jonet.
 - Radikalet.
 - Ai nuk ka renditje të rregullt.
21. Rretho opsionin që NUK ËSHTË i saktë në lidhje me elementet alkaline:
- Lehtë pranojnë elektrone.
 - Lehtë oksidohen.
 - Kanë energji të vogël të jonizimit.
 - Të gjithat janë metale tipike.
 - Vrullshëm reagojnë me ujin.
22. Formula e oksidit të plumbit katër valent është:
- Pb_2O
 - PbO
 - PbO_2
 - PbO_4
 - Pb_2O_4
23. Me tretjen e SO_2 në ujë fitohet:
- Acidi hidrogjen sulfuror.
 - Acidi sulfuror.
 - Acidi sulfurik.
 - Acidi persulfurik.
 - Acidi supersulfurik.
24. Formula e selenatit të taliumit (III) është:
- TlSeO_4
 - TlSeO_3
 - $\text{Tl}(\text{SeO}_4)_2$
 - $\text{Tl}_2(\text{SeO}_3)_3$
 - $\text{Tl}_2(\text{SeO}_4)_3$
25. Kripë e dyfishtë është:
- NaHCO_3 .
 - $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$.
 - $\text{CaCl}_2 \cdot \text{H}_2\text{O}$.
 - $\text{AlK}(\text{SO}_4)_2 \cdot 12\text{H}_2\text{O}$.
 - NaCl .

II. DETYRA

(Shënoni rezultatin në drejtëkëndëshin e zbrazët që gjendet nën secilën detyrë!

Detyrat zgjidhni në fletat shtesë që do t'u jepen!)

1. Trikloracetaldehidi është mjet hipnotik (gjumësjellës). Formula e tij kimike është $\text{Cl}_3\text{CCH}(\text{OH})_2$. Llogarit sa është masa e 10 molekulave të trikloracetaldehidit.

Rezultati:

2. Nitrat i amonit përdoret si njëra prej komponentëve të plehrave artificiale. E një rëndësie të veçantë është njohja e pjesëmarrjes masore të komponentëve të ndryshëm në plehurat artificiale. Llogarit pjesëmarrjen masore të azotit në nitrat amoni të pastër dhe paraqite atë në%.

Rezultati:

3. Sa është sasia e jodit, $n(\text{I})$, në 12,0 g tetrajodmerkur argjendi (II): $\text{Ag}_2[\text{HgI}_4]$?

Rezultati:

4. Gjatë bashkëveprimit të acidit klorhidrik me 1,8 g përzierje të gjipsit dhe kalcitit lirohet dioksid karboni që në kushte standarde zë vëllim prej 291 cm^3 . Sa është pjesëmarrja masore e kalcitit, d.m.th. e karbonatit të kalciumit në përzierjen e dhënë në %?

Rezultati:

5. Sa është vëllimi i 196 mg dioksid karbonit në gjendje të gaztë (i shprehur në cm^3) në kushte standarde?

Rezultati:

Të dhëna të cilat mund të të nevojiten:

$$\begin{array}{lllll} A_r(\text{H}) = 1,0 & A_r(\text{O}) = 16,0 & A_r(\text{C}) = 12,0 & A_r(\text{Cl}) = 35,4 & A_r(\text{N}) = 14,0 \\ A_r(\text{I}) = 126,9 & A_r(\text{Ag}) = 107,9 & A_r(\text{Hg}) = 200,6 & A_r(\text{Ca}) = 40,1 & \end{array}$$



Emri dhe mbiemri i garuesit: _____
Ermri dhe mbiemri i mentorit: _____
Shkolla: _____ Komuna: _____

PËR KOMISIONIN
Gjithësej pikë: _____
Prej pyetjeve: _____ prej detyrave: _____
Kontrolloi: _____


I. TEST ME MË SHUMË PËRGGJIGJE TË DHËNA PREJ TË CILAVE VETËM NJËRA ËSHTË E SAKTË
(Përgjigje jepni në atë mënyrë, duke rrethuar **vetëm një** prej opsioneve të dhëna A, B, C, D ose E)

1. Energjia e aktivizimit për një reaksion që shkon deri në fund, gjatë ndryshimit të arritjes së reaksionit për 1 mol, paraqet:
- A. Shumën e energjive të reaktantëve dhe produkteve
 - B. Shumën e energjisë së reaktantëve dhe energjisë së kompleksit të aktivizuar.
 - C. Shumën e energjisë së produkteve dhe energjisë së kompleksit të aktivizuar.
 - D. Dallimin në mes të energjisë së produkteve dhe energjisë së reaktantëve.
 - E. Dallimin në mes të energjisë së kompleksit të aktivizuar dhe energjisë së reaktantëve.
2. Gjatë ekuilibrit, në ndonjë temperaturë, për reaksionin të dhënë me anë të barazimit $2\text{H}_2 + \text{O}_2 \rightleftharpoons 2\text{H}_2\text{O}$ është e mundshme të ekzistojnë:
- A. 1 mol H_2 , 2 mol O_2 dhe 3 mol H_2O .
 - B. 2 mol H_2 , 2 mol O_2 dhe 3 mol H_2O .
 - C. 3 mol H_2 , 2 mol O_2 dhe 3 mol H_2O .
 - D. 4 mol H_2 , 2 mol O_2 dhe 3 mol H_2O .
 - E. Të gjitha opsionet e cekura më lartë janë të mundshme.
3. Gjeje elementin që nuk e ka vendin në opsionet e dhëna:
- A. Klor.
 - B. Sulfur.
 - C. Oksigjen.
 - D. Azot.
 - E. Argon.
4. Çfarë do të ndodh me shpejtësinë e reaksionit në qoftë se përqëndrimi rritet për 5 herë, ndërsa temperatura zvogëlohet për 20°C ?
- A. Do të rritet.
 - B. Do të zvogëlohet.
 - C. Do të mbetet e njëjtë.
 - D. Së pari do të zvogëlohet, e më pas do të rritet.
 - E. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të dhënë përgjigje.
5. Gjatë tretjes në ujë, numri i joneve i substancave të tretura do të rritet në mënyrë të konsiderueshme te:
- A. Fluorhidriku.
 - B. Klorhidriku.
 - C. Bromhidriku.
 - D. Jodhidriku.
 - E. Në të gjitha rastet e lartëpërmendura.
6. Korrozionit (gërryerjes) i nënshtrohen gjësendet prej :
- A. Leshi.
 - B. Plastike.
 - C. Bakri.
 - D. Ari.
 - E. Të gjitha opsionet e lartëpërmendura.
7. Në temperaturë 95°C produkti jonik i ujit ka vlerën $1 \cdot 10^{-12} \text{ mol}^2 \text{ dm}^{-6}$. Në cilin rast tretësira do të jetë bazike?
- A. Në $\text{pH} = 7$
 - B. Në $\text{pH} = 6$
 - C. Në $\text{pH} = 5$
 - D. Në $\text{pH} = 4$
 - E. Në $\text{pH} = 3$
8. Hidrolizë do të ketë në tretësirë ujore të:
- A. Klorur amoni.
 - B. Acetat kaliumi.
 - C. Karbonat natriumi.
 - D. Sulfat alumini.
 - E. Të gjitha kripërat e lartëpërmendura.
9. Komponimi H_5IO_6 e acidit ortoperjodik. Cila është formula e acidit metaperjodik?
- A. H_4IO_4 .
 - B. H_3IO_4 .
 - C. H_2IO_4 .
 - D. HIO_4 .
 - E. Asnjëra nga opsionet e dhëna.
10. Emërto komponimin $\text{Cu}_2\text{CO}_3(\text{OH})_2$
- A. Hidroksidi karbonik i bakrit
 - B. Karbonati i bakrit dihidroksid.
 - C. Hidroksidi i karbonatit të bakrit (II).
 - D. Karbonati i barkit (II) me dy grupe hidrokside.
 - E. Monokarbonati i hidroksidit të bakrit.
11. Kur diskutojmë për energjinë elektrike, si zakonisht mendojmë për:
- A. Elektrolizë.
 - B. Lëvizje e elektroneve ose joneve nëpërmjet një përçuesi të rendit të parë ose rendit të dytë.
 - C. Rrufenë ose bubullimën.
 - D. Element elektrokimik.
 - E. Një „prizë“ elektrike.
12. Cilat jone mund ti konsiderojmë edhe si acide edhe si baza (sipas brenshded-it)?
- A. HCO_3^- .
 - B. CO_3^{2-} .
 - C. H_3O^+ .
 - D. NH_4^+ .
 - E. CH_3COO^- .

13. Cilat prej formulave të dhëna më poshtë janë formula të sakta të kripërave të acidit sulfurik?

- A. NaHSO₄ BaSO₃
 B. Ca(SO₄)₂ (NH₄)₂SO₄
 C. MgSO₄ MgHSO₄·7H₂O
 D. KHSO₄ Al₂(SO₄)₃
 E. NH₄(SO₄)₂ BaSO₄

14. Reaksioni i „djegies“ së piritit është dhënë me anë të barazimit në vijim



Cili prej opsioneve të dhëna më poshtë është i saktë në lidhje me reaksionin e dhënë sipas këtij barazimi?

- A. Oksigjeni është oksiduar.
 B. Piriti është lëndë oskiduese.
 C. Sulfuri ka pësuar ndryshim të numrit oksidues prej 4+ në 2+.
 D. Hekuri është oksiduar.
 E. Asnjëri prej opsioneve nuk është i saktë.

15. Cili prej opsioneve nuk e ka vendin këtu:

- A. Argjent një valent.
 B. Bakër dy valent.
 C. Alumin tri valent.
 D. Plumb katër valent.
 E. Silic pesë valent.

16. Cili prej acideve i cili gjatë bashkëveprimit me zinkun pluhur nuk do të jep hidrogjenin si produkt?

- A. HNO₃(aq).
 B. HCl(aq).
 C. H₂SO₄(aq).
 D. H₃PO₄(aq).
 E. CH₃COOH(aq).

17. Soda për larje për nga përbërja kimike është:

- A. NaHCO₃.
 B. Na₂CO₃.
 C. Na₂O.
 D. NaOH.
 E. NaCO₃·10H₂O

18. Madhësitë (majtas: 1, 2, 3, 4) ndërlidhi me njësitë (djathtas: A, B, C, D):

1. Shtypja	A. kg m s ⁻²
2. Puna	B. kg m ⁻¹ s ⁻²
3. Forca	C. mol s ⁻¹
4. Shpejtësia e reaksionit	D. kg m ² s ⁻²

- A. 1–A, 2–D, 3–C, 4–B.
 B. 1–B, 2–D, 3–A, 4–C.
 C. 1–D, 2–C, 3–B, 4–A.
 D. 1–C, 2–B, 3–A, 4–D.
 E. 1–B, 2–A, 3–D, 4–C.

19. Cili prej opsioneve nuk e ka vendin këtu?

- A. Litiumi.
 B. Argjenti.
 C. Hekuri.
 D. Bakri.
 E. Natriumi.

20. Gjatë fitimit të bakrit prej kalkopiritit, i saktë është reaksioni i paraqitur me anë të barazimit kimik:

- A. 2CuS + 3O₂ = 2CuO + 2SO₂.
 B. 2Cu₂S + 3O₂ = 4Cu + 2SO₃.
 C. 2Cu₂S + 3O₂ = 2Cu₂O + 2SO₂.
 D. CuFeS₂ + 3O₂ = CuO + FeO + 2SO₂.
 E. 2Cu₂O + S = 4Cu + SO₂.

21. Cili prej oksideve nuk mund të ekzistojë?

- A. SO₃.
 B. SO₂.
 C. SO.
 D. CO₃.
 E. CO₂.

22. Cili prej reaksioneve kimike (i përshkruar me anë të ekuacionit që nuk është i barazuar) është i pamundur të zhvillohet:

- A. KMnO₄ → K₂O + MnO₂ + O₂.
 B. KMnO₄ + HCl → KCl + MnCl₂ + Cl₂ + H₂O.
 C. KMnO₄ + CO₂ → K₂CO₃ + Mn₂O₇.
 D. KMnO₄ + CO₂ → K₂CO₃ + MnO₂.
 E. KMnO₄ + SO₂ → K₂SO₄ + Mn₂O₃ + SO₃.

23. Sa është (përafërsisht) koeficienti i temperaturës së reaksionit, nëse dijmë se me rritjen e temperaturës për 40 °C shpejtësia e reaksionit është rritur për 80 herë?

- A. 2
 B. 3
 C. 4
 D. 8
 E. 20

24. Efikasiteti i oksidimit të SO₂ në SO₃ në ajër dhe në prezencë të NO₂ si katalizator nuk varet nga:

- A. Temperatura.
 B. Sasia e NO₂.
 C. Shtypja.
 D. Sasia e SO₂.
 E. Sipërfaqja e kontaktit të katalizatorit.

25. Rretho mjetin më të dobët reduktues:


- A. Argjenti.
 B. Magnezi.
 C. Alumini.
 D. Zinku.
 E. Bakri.

II. DETYRA

(Shënoni rezultatin në drejtëkëndëshin e zbrazët që gjendet nën secilën detyrë!



Detyrat zgjidhni në fletat shtesë që do t'u jepen!)

1. Barazo ekuacionin e reaksionit redoks me anë të skemës elektronike!




Në të mjet oksidues është _____, ndërsa mjet reduktues është _____.

2. Në bazë të vlerave të njohura të entalpiave standarde të reaksioneve të dhëna me anë të barazimeve termokimike:



të përcaktohet entalpia standarde e reaksionit kimik të dhënë me anë të barazimit termokimik:



Rezultati:

3. Gjatë arritjes së ekuilibrit kimik të dhënë me anë të ekuacionit:



në temperaturë 303 K, shtypja e përgjithshme është 0,016 atm. Sa është shtypja parciale (e pjeshme) e hidrogjenit dhe avujve të ujit në sistemin ekuilibruar, në qoftë se vlera e K_p është 0,23? [Shtypja e përgjithshme është shuma e shtypjeve parciale.]

Rezultati:

4. Sa është vlera e pH-së së tretësirës së fituar gjatë përzierjes së 20 mL tretësirë të hidroksidit të natriumit me përqëndrim sasior së substancës së tretur 0,002 mol/L dhe 15 mL tretësirë të hidroksidit të natriumit me përqëndrim sasior të NaOH 0,02 mol/L? Të merret parasysh se temperatura e tretësirës është 25 °C.

Rezultati:

5. 25 orë pas fillimit të reaksionit kimik hipotetik (të supozuar) të dhënë sipas ekuacionit:



nuk mund të përcaktohet prania e reaktantit A . Nëse dihet se sasia fillestare e reaktantit A ka qenë 18 mol, të llogaritet sa ka qenë shpejtësia e reaksionit, dhe sa ka qenë shpejtësia e ndryshimit të përqëndrimit të pjesëmarrësit A. Vëllimi i sistemit reagues është 5L



Rezultati:




Emri dhe mbiemri i garuesit: _____
 Emri dhe mbiemri i mentorit: _____
 Shkolla: _____ Komuna: _____






PËR KOMISIONIN
 Gjithësej pikë: _____
 Prej pyetjeve: _____ prej detyrave: _____
 Kontrollloi: _____


I. TEST ME MË SHUMË PËRGGJIGJE TË DHËNA PREJ TË CILAVE VETËM NJËRA ËSHTË E SAKTË
 (Përgjigjuni në atë mënyrë, duke rrethuar **vetëm një** prej opsioneve të dhëna A, B, C, D ose E)

- Sa lidhje σ ka në molekuelën në vijim?
 $\text{CH}_3-\text{CH}=\text{C}=\text{CH}-\text{C}\equiv\text{C}-\text{H}$
 A. 10
 B. 11
 C. 8
 D. 15
 E. 7
- Çfarë përfaqësojnë në ves veti komponimet në vijim?

 A. Izotope
 B. Homolizë.
 C. Izomerë.
 D. Enantiomerë.
 E. Nuk kanë asnjë lidhje të përbashkët.
- Cili prej opsioneve nuk e ka vendin këtu!
 A. CN^-
 B. RNH_2
 C. BF_3
 D. $:\text{CH}_3$
 E. HO^-
- Si është emri i komponimit në vijim (IUPAC)?

 A. Dimetil cikloheksan.
 B. Dimetil benzen.
 C. 1,3-dimetil cikloheksan.
 D. *cis*-1,3-dimetil cikloheksan.
 E. *trans*-1,3-dimetil cikloheksan.
- Sa është numri i strukturave izomere të heksanit?
 A. 2 B. 3 C. 4
 D. 5 E. 6
- Cili komponim fitohet gjatë bashkëveprimit të reaktantëve të dhënë në vijim?
 $\text{CH}_3\text{Cl} + 2\text{Na} + \text{CH}_3\text{CH}_2\text{Cl} \rightarrow ?$
 A. Propani. B. Metani. C. Etani.
 D. Pentani. E. Butani.

- Cili është produkti që fitohet bazuar në ekacionin e dhënë në vijim?



- 
- 
- 
- 
- Asnjë prej opsioneve të dhëna.
- Si emërtohet grupi në vijim?
 $\text{H}_2\text{C}=\text{CH}-$
 A. Etil.
 B. Vinil.
 C. Grupi metilik.
 D. Etilil.
 E. Alil.
- Sa izomerë të tribrombenzenit mund të ekzistojnë?
 A. 1 B. 0 C. 2
 D. 3 E. 4
- Cila prej formulave të dhëna në vijim është formula e fenantrenit?

 A. IV.
 B. Asnjëra.
 C. I.
 D. II.
 E. III.
- Cili prej pohimeve të dhëna është i saktë!
 A. Propanoni reduktohet deri në propan-2-ol.
 B. Propanoni oksidohet deri në propan-2-ol.
 C. Propanoni reduktohet deri në propan-1-ol.
 D. Propanoni oksidohet deri në propan-1-ol.
 E. Propanoni oksidohet deri në propan.

12. Sa është këndi i lidhjeve C-C-C të ciklopropani?
- A. 30 °.
B. 60 °.
C. 90 °.
D. 120 °.
E. 109 °.
13. Cili komponim fitohet gjatë reaksionit të paraqitur në ekuacionit në vijim?
 $\text{CH}_3\text{CH}=\text{CH}_2 + \text{H}_2\text{O} \rightarrow ?$
- A. Propan-1-ol.
B. Propanal.
C. Propanon.
D. Propan-2-ol.
E. Propin.
14. Cila është renditja e saktë e rritjes së temperaturës së valimit të alkanëve në vijim?
I. $\text{C}_{12}\text{H}_{26}$ II. $\text{C}_{33}\text{H}_{68}$ III. C_7H_{16} IV. $\text{C}_{55}\text{H}_{112}$
- A. III > I > II > IV
B. IV < II < III < I
C. IV > II > I > III
D. III > II > IV > I
E. I > III > II > IV
15. Cili komponim fitohet gjatë bashkëveprimit të klorurit të propilmagnezit?
- A. Propil kloruri.
B. Propen.
C. Propan-1-ol.
D. Propin.
E. Propan.
16. Prej cilit komponim me eliminim të bromit fitohet pent-2-en?
- A. 2,3-dibrompentan.
B. 1,2-dibrompentan.
C. 2-brompentan.
D. 1-brompentan.
E. 3-brompentan.
17. Për cilin prej komponimeve të dhëna izomeria gjeometrike është e pamundur?
- A. Hept-3-en.
B. Heks-2-en.
C. But-2-en.
D. Pent-1-en.
E. Okt-3-en.
18. Cili prej komponimeve në vijim nuk mund të marr pjesë në reaksion të polimerizimit?
- A. Tetrafluoreteni.
B. Kloreteni.
C. 1,2-dikloreteni.
D. Propen.
E. 2-metilbuta-1,3-dien.
19. Sa është n te formula e përgjithshme e cikloalkaneve?
- A. $n \geq 3$.
B. $n \leq 3$.
C. $n \geq 1$.
D. $n \geq 2$.
E. $n = 1$
20. Cili reaksion është karakteristik për benzenin?
- A. Adicionimi elektrofil.
B. Substitucioni elektrofil.
C. Substitucioni nukleofil.
D. Adicionimi nukleofil.
E. Eliminimi.
21. Reaktiviteti i benzenit për nitrim është
- A. më e madhe se reaktiviteti i toluenit.
B. më e madhe se reaktiviteti i fenolit.
C. i njëjtë me reaktivitetin e fenolit.
D. më e madhe se reaktiviteti edhe i toluenit dhe fenolit.
E. i njëjtë me reaktivitetin e toluenit.
22. Cili është emri i komponimit në vijim?
- 
 $\text{CH}_2\text{CH}_2\text{CH}_2\text{CH}_2\text{OH}$
- A. 4-fenilbutan-1-ol.
B. 1-fenilbutan-4-ol.
C. Alkool benzilpropil.
D. Benzen butanol.
E. 4-benzilbutan-1-ol.
23. Në reaksionet me metalet alkaline, alkoole të sillen si:
- A. akceptor të protonit.
B. kripëra.
C. amfiprotolitë.
D. baza.
E. acide.
24. Si është pH-ja e tretësirave ujore të fenolit?
- A. Acidike.
B. Neutrale.
C. E dobët bazike.
D. E fortë bazike.
E. Fenoli nuk tretet në ujë.
25. Si është hibridizimi tek atomi i karbonit në grupën aldehide?
- A. sp B. sp^2 C. sp^3
D. sp^2-p E. sp^2-s

II. DETYRA

(Shënoni rezultatin në drejtëkëndëshin e zbrazët që gjendet nën secilën detyrë!
Detyrat zgjidhni në fletat shtesë që do t'u jepen!)

1. Sa është numri i atomeve që gjenden në 307,2 g tetraklormetan?

Rezultati:

2. Llogarit pjesëmarrjet sasiore dhe masore të elementeve në diklorbenzen!

Rezultati:

3. Pjesëmarrjet masore të elementeve në një komponim organik janë si një vijim: $w(\text{C}) = 65,4\%$, $w(\text{H}) = 5,5\%$ и $w(\text{O}) = 29,1\%$. Gjeje formulën empirike të komponimit!

Rezultati:

4. Gjatë djegies së 33,5 g propen, janë fituar 16,1 g ujë. Sa është rendimenti i reaksionit të shprehur në përqindje?

Rezultati:

5. Sa është masa e ujit që do të fitohet gjatë djegies së 209 g metanol?

Rezultati:

Të dhëna të cilat mund të të nevojiten:

$$A_r(\text{H}) = 1,01; \quad A_r(\text{C}) = 12,0; \quad A_r(\text{O}) = 16,0; \quad A_r(\text{Cl}) = 35,4;$$